



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Seancë plenare e Kuvendit

S- 020

Prishtinë, më 21 maj 2008, në orën 15:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
21 MAJ 2008

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi Naim Maloku, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 101 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari informoi deputetët lidhur me raportin dhe rekomandimet e Komisionit ad-hoc për shqyrtimi e dytë të grupit të tretë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit.

Komisioni ad hoc i kishte rekomanduar Kuvendit që shqyrtimin e dytë të Projektligjit për festat zyrtare të Republikës së Kosovës ta shtyjë për dy ditë, me arsyetimin se i duhet kohë shtesë për t'i harmonizuar qëndrimet lidhur me këtë projektligj.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Komisionit ad-hoc. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për--- shumica absolute,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi propozimin e Komisionit ad hoc që Projektligji për festat zyrtare të Republikës së Kosovës të shqyrtohet më 23 maj 2008.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Shqyrtimi i dytë i Grupit të tretë të projektligjeve nga Propozimi i Martti Ahtisaarit, sipas procedurës së veçantë:

- 1.1 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës,
- 1.2 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë,
- 1.3 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit,
- 1.4 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror,
- 1.5 Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azil.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit ad-hoc t'i arsyetojë rekomandimet për këtë projektligj.

Deputeti **Lutfi Haziri**, në emër të Komisioni ad-hoc, tha se në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kosovës, datë 15 shkurt 2008, Komisioni në mbledhjet e mbajtura më 20 dhe 21 maj 2008, ka shqyrtuar projektligjet e grupit të tretë të projektligjeve të miratuara në seancën e mëparshme dhe Kuvendit ia ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Komisioni, pasi shqyrtoi Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, njëzëri vendosi t'i rekomandojë Kuvendit ta miratojë Projektligjin me dy amendamente të propozuara.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet Komisionit ad-hoc në Projektligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi amendamentet: 1 dhe 2.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 83;
Kundër----- 3.
Abstenime-----15.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Komisionit ad-hoc ta arsyetojë Raportin me rekomandime për Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

Deputeti **Lutfi Haziri** tha se Komisioni ad hoc ka shqyrtuar Projektligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë dhe njëzëri ka vendosur t'i rekomandojë Kuvendit miratimin e Projektligjit me amendamentet e propozuara.

Kryetari i hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni ad-hoc.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5 dhe 6.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 92;
Kundër----- 6.
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni ad-hoc.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2 dhe 3.

Kryetari hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 75;
Kundër----- 7.
Abstenime-----10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e propozuara nga Komisioni ad-hoc.

Kuvendi, me shumicë votash, miratoi këto amendamente: 1 dhe 2.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 91;
Kundër----- 4.
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për menaxhimin e integruar dhe kontrollin e kufirit shtetëror.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për azil

Komisioni ad hoc kishte shqyrtuar Projektligjin për azil dhe Kuvendit i kishte rekomanduar ta miratojë atë në formën e propozuar.

Kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 87;
Kundër----- 6.
Abstenime-----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për azilin.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 15:40 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale